



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Për arsye humanitare bindëse, Trupi Gjykses ka udhëzuar Zyrën Administrative që të menaxhojë një vizitë nën mbikëqyrje të z. Krasniqi në Kosovë për të takuar anëtarë të familjes së ngushtë. I akuzuari mbetet në paraburgim të Dhomave të Specializuara. EULEX-i dhe Policia e Kosovës po i japin mbështetje Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Më 3 tetor 2024, Kryetarja Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi kërkesën referuese të Salih Mustafës, të 27 shtatorit, në të cilën ai, ndër të tjera, pretendon se iu shkelën të drejtat kushtetuese kur Gjykata Supreme lejoi Mbrojtësin e Viktimave të paraqiste parashtrime në lidhje me kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kur Gjykata Supreme vendosi se legjislacioni jugosllav i vitit 1976 nuk ishte i zbatueshëm si bazë për përcaktimin e shkallëzimit të dënimit. Z. Mustafa kërkoi gjithashtu që çështja gjyqësore të kthehej për rigjykim te Trupi Gjykses përkatës. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet prej gjykatësve Vidar Stensland, Rumen Nenkov, and Romina Inkuti.

Më 4 tetor, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Haxhi Shalës dhe Sabit Januzit. Lidhur me Haxhi Shalën, Trupi Gjykses konstatoi rrezikun që ai të arratiset. Në lidhje me të dy të akuzuarit, Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që ata të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë krime të tjera. Në veçanti, Trupi Gjykses konstatoi se ata të dy kanë motivin, mjetet dhe mundësinë për të ushtruar trysni ndaj dëshmitarit 1 dhe për ta bindur atë që të mos japë dëshmi, ose për të manipuluar provat në ndonjë mënyrë tjetër. Trupi Gjykses gjykoj më tej se fillimi i afërt i gjykimit dhe qasja e shtuar e të akuzuarve në informacion të ndjeshëm lidhur me dëshmitarë si rezultat i procesit të vazhdueshëm të nxjerrjes së provave, përbëjnë faktorë relevantë për vlerësimin e mundësisë se të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit. Trupi Gjykses përfundoi se komunikimet e të akuzuarve mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Në çështjen gjyqësore të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës, më 7 dhe 8 tetor, Trupi Gjykses mbajti konferencat përgatitore për të diskutuar çdo aspekt që duhet zgjidhur për një fillim të shpejtë të gjykimit. Pas diskutimeve lidhur me, ndër të tjera, hetimet, provat dhe nxjerrja e pritshme e tyre, Trupi Gjykses lëshoi një numër urdhrash gojorë më 8 tetor.

Trupi Gjykses mori parasysh konfirmimin nga ekipet e Mbrojtjes të z. Shala dhe z. Bahtijari lidhur me gatishmërinë dhe disponueshmërinë për të filluar gjykimin të premtën, më 8 nëntor 2024, dhe që seancat gjyqësore të mbahen javën 11 deri më 15 nëntor. Trupi Gjykses vendosi se në rastin e z. Januzi, kryembrojtësi





nuk do të jetë i disponueshëm gjatë disa ditëve, dhe në ato ditë, z. Januzi do të përfaqësohet nga bashkëmbrojtësi.

Trupi Gjykses ftoi ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë parashtrime me shkrim, nëse dëshirojnë, lidhur me propozimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar mbi paraqitjen dhe pranueshmërinë e provave jогоjore; llojin publik të procesit; dhe zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procesit, deri jo më vonë se të mërkurën, 16 tetor. Trupi Gjykses ftoi ekipet e Mbrojtjes që, deri në të njëjtin afat, të dorëzojnë parashtrime në lidhje me praktikën e përgatitjes së dëshmitarëve.

Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorinë të dorëzojë çdo kërkesë për pranim të provave që nuk janë dëshmi të dëshmitarëve deri më 15 tetor. Në qoftë se ekipet e Mbrojtjes dëshirojnë t'u përgjigjen parashtrimeve të Prokurorisë, ai i urdhëroi ata që t'i dorëzojnë deri më 22 tetor. Çdo përgjigje shtesë e Prokurorisë duhet të dorëzohet deri më 25 tetor 2024.

Trupi Gjykses urdhëroi ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë gjithashtu listat përkatëse të dëshmitarëve deri më 4 nëntor. Këto lista, ndër të tjera, duhet të përfshijnë: kohëzgjatjen e gjithsejtë të përllogaritur për paraqitjen e provave prej secilit ekip të Mbrojtjes; numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve që pritet të japin dëshmi për secilin prej të akuzuarve, përfshirë nëse vetë i akuzuari pritet të japë dëshmi; një përmbledhje të fakteve për të cilat pritet të dëshmojë secili prej dëshmitarëve; akuzat në Aktakuzë për të cilat pritet të dëshmojë secili prej dëshmitarëve, përfshirë referimet konkrete në lidhje me akuzat; dhe një përllogaritje të kohëzgjatjes së gjithsejtë të pyetjeve të palës thirrëse për çdo dëshmitar. Krahas kësaj, Trupi Gjykses udhëzoi ekipet e Mbrojtjes që, në parashtrimet e tyre përkatëse, të përfshijnë çdo kërkesë për masa mbrojtëse ose fletëthirrje. Prokuroria u urdhërua që të paraqesë përgjigje ndaj kërkesave të Mbrojtjes jo më vonë se 11 nëntori; dhe Mbrojtja të dorëzojë kundërpërgjigje jo më vonë se 14 nëntori 2024.

Në lidhje me pyetjen nëse Prokuroria duhet të lexojë një përmbledhje të Aktakuzës gjatë hapjes së gjykimit, në vend të dokumentit në tërësi, Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorinë dhe Mbrojtjen e Januzit që, ose të dorëzojnë propozim të përbashkët për përmbledhje të Aktakuzës, ose të informojnë Trupin Gjykses se nuk është arritur marrëveshje për një propozim të tillë. Nëse ndodh kjo e fundit, Aktakuza do të lexohet në tërësi gjatë hapjes së çështjes gjyqësore. Trupi Gjykses caktoi afatin për të premtën, 1 nëntor.

Trupi Gjykses hodhi poshtë parashtrimin e Mbrojtjes së Januzit se nuk ka mundësi të përfundojë hetimet nga eksperti i saj para se Prokuroria të dorëzojë provat kriminalistike të disa telefonave mobilë. Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen e Januzit të kontaktonte Zyrën Administrative dhe Zyrën e Mbrojtjes menjëherë për të bërë organizimet e nevojshme për sigurimin e ndihmës nga eksperti dhe të vijonte pa vonesë me hetimet e parapara të saj.

Trupi Gjykses udhëzoi Prokurorinë dhe Zyrën Administrative që t'u ofrojnë ekipeve të Mbrojtjes ndihmë teknike për t'u siguruar atyre qasje në kopjet forenzike të disa telefonave mobilë të sekuestruar. Trupi





Gjykues udhëzoi palët dhe Zyrën Administrative që në të ardhmen të jenë proaktivë në komunikim me njëri-tjetrin për t'i zgjidhur problemet teknike pa vonesë.

Trupi Gjykues bëri të ditur se synon të fillojë gjykimin më 8 nëntor 2024, ku dëshmitari i parë të thirret javën vijuese, dhe se do të lëshojë një vendim mbi datën e fillimit, si dhe mbi informimin ose përgatitjen e dëshmitarëve; zhvillimin e gjykimit; dhe mbi parashtrimin dhe pranueshmërinë e provave jोगojore.

Seanca e ardhshme para Dhomave të Specializuara është caktuar për 21 tetor 2024 në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*.

Në lajme të tjera, Kryetarja e Dhomave të Specializuara Ekaterina Trendafilova këtë javë udhëtoi për në Kosovë për takime dypalëshe, përfshirë me PSBE-në, shefin e Misionit të EULEX-it, përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së dhe Ministren e Drejtësisë. Qëllimi i udhëtimit ishte që të ofrohej informacion publik lidhur me aktivitetet aktuale të gjykatës. Kryetarja Trendafilova planifikon t'u drejtohet shoqërisë civile dhe mediave në Kosovë në një të ardhme të afërt.

Pyetje

Pas konferencës, një gazetar pyeti për agjendën dhe masat e aplikueshme të sigurisë gjatë vizitës nën mbikëqyrje të Jakup Krasniqit në Kosovë këtë javë. Zëdhënësja e DHSK-së, Angela Griep, u përgjigj se nuk mund të komentonte për çështjet operative që lidhen me vizitën.

Gazetari pyeti gjithashtu nëse Haxhi Shala kishte kërkuar vizitë nën mbikëqyrje pas vdekjes së një familjari të tij, dhe nëse po, si i ishin përgjigjur gjykatësit kësaj kërkesë. Angela u përgjigj se nuk mund të komentojë në këtë moment.

Gazetari pyeti për rezultatin e vizitës së Kryetares Trendafilova në Kosovë këtë javë dhe nëse ka ndonjë informacion lidhur me zbatimin e urdhrin për zhdëmtimin e viktimave në çështjen Salih Mustafa.

Angela u përgjigj se Kryetarja në takimet e saj dypalëshe në Kosovë ka ofruar informacione publike për aktivitetet e gjykatës dhe shpjegoi vendimin më të fundit të gjykatësit të vetëm i cili po mbikëqyr zbatimin e urdhrin për zhdëmtimin e viktimave në çështjen Mustafa. Gjykatësi konstatoi se urdhri për zhdëmtim mund të zbatohet menjëherë duke qenë se z. Mustafa nuk e ka apeluar atë dhe pasi që ka një aktgjykim të formës së prerë në këtë çështje. Ai gjithashtu e ftoi z. Mustafa që të bëjë çdo pagesë vullnetare dhe urdhëroi Administratoren që ta informojë atë për modalitetet. Ai gjithashtu lëshoi urdhra në lidhje me pronat e mundshme të z. Mustafa të cilat do të përdoren për zbatimin e pjesëshëm të urdhrin për zhdëmtim sipas pagesave proporcionale për viktimat. Gjykatësi i vetëm theksoi gjithashtu se para se të dorëzohet ndonjë kërkesë të mundshme në kuadër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit në Kosovë, duhet të përcaktohet nëse dhe në çfarë mase z. Mustafa mund t'a paguajë vetë urdhrin për zhdëmtim brenda një kohe të arsyeshme.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr. 38/2024
Hagë, 10/10/2024

